

POP

Buletin informativ

Në këtë numër

**Advokimi dhe lobimi
për përmbushjen e
Kontratave Sociale**

**Monitorimi i Zgjedhjeve
Parlamentare
25 prill 2021**

**Forumet Publike
në kuadër të Zgjedhjeve
parlamentare 2021**

Përballja e Ofertave Politike

T: +355 4 22 555

C: +355 69 61 20 169

E: perballjaeofertavepolitike@gmail.com

A: Rr. "Abdyl Frasheri", P.10/1, Tiranë

W: <https://popnetwork.al/>



Rrjeti POP

Rrjeti POP vijon punën dhe aktivitetet në kuadër të rritjes së përgjegjshmërisë së zyrtarëve në nivel vendor për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve në 9 bashkitë ku POP ka përpiluar Kontratën Sociale.

Megjithëse 2020 ishte një vit i vështirë për shkak të pandemisë COVID-19, bazuar në iniciativat e anëtarëve të rrjetit dhe metodologjisë për monitorim 17 % e prioriteteve të qytetarëve të: Tiranës, Durrësit, Vlorës, Shkodrës, Pukës, Kamzës, Kukësit, Pogradecit dhe Fierit u përmbushën plotësisht nga ana e bashkive respektive. Gjithashtu, 58% e këtyre prioriteteve u adresuan dhe u përmbushën në mënyrë të pjesshme, duke lënë të paprekura 17 % të tyre. Dhe, pikërisht për këto prioritete të papërmbushura, Rrjeti POP gjatë muajve të parë të vitit u fokusua në fushata advokimi dhe lobimi, qofshin ato në nivel vendor por edhe në nivel qendror.

Të gjitha këto fushata kulmuan në forumet publike përpara Zgjedhjeve Parlamentare të 25 prillit 2021.


Advokimi dhe lobimi për përmbushjen e Kontratave Sociale

Anëtarët e Rrjetit POP gjatë muajve të parë të 2021 ndërmorën fushata dhe takime advokuese sa i përket plotësimit të prioriteteve të Kontratave Sociale në 9 bashki të vendit. Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Pogradec, Kukës, Kamëz, Pukë, Durrës dhe Fier. Qëllimi i këtyre fushatave ishte progresi i prioriteteve të Kontratave Sociale sipas bashkive respektive.



PUKË

Lëvizja Rinore për Demokraci: Takim në format hibrid më pjesëmarrje të anëtarëve të shoqërisë civile dhe përfaqësues të bashkisë Pukë. Progresi i Kontratës Sociale të kësaj bashkie në vitin e parë të monitorimit ka 4 prioritete të adresuara plotësisht, 4 prioritete janë adresuar pjesërisht dhe 6 prej prioriteteve të kësaj kontrate nuk e kanë marrë akoma vëmendjen e bashkisë.




KAMËZ



Shoqata për Integrimin e Zonave Informale: Gjatë vitit të parë të monitorimit nga 9 prioritete të Kontratës Sociale u arritën të adresoheshin pjesërisht 7 prioritete, ndërkohë që 1 prej prioriteteve është adresuar plotësisht por “Informimi i komunitetit në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror për grupet në nevojë dhe përmirësimi i shërbimeve sociale pranë Njësive Administrative” nuk është adresuar akoma. Klikoni këtu dhe ndiqni Premium Channel për të mësuar më shumë mbi progresin e prioriteteve të Kontratës Sociale për bashkinë Kamëz.

POGRADEC

Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim: Asnjë prej 10 prioriteteve të Kontratës Sociale pranë kësaj bashkie nuk është adresuar plotësisht, por 6 prej tyre janë adresuar pjesërisht duke përmbyshur 60% të saj. Ndërkohë në **takimet e marsit** me anëtarët e Këshillit bashkiak pranë kësaj bashkie u lobua për angazhimin e këtij këshilli në përmbyshjen e plotë të prioriteteve të qytetarëve të Pogradecit.



01 PRIORITYET: Funkcionimi i mekanizmeve që sigurojnë shkëmbimin reciprok të informacionit dhe transparencën e vendimeve që merr Bashkia dhe Këshilli Bashkiak ndaj komunitetit. Adresuar pjesërisht.

02 PRIORITYET: Specifikimi i një zëri buxhetor për të rinjtë në buxhetin vjetor që harton Bashkia. Adresuar pjesërisht.

03 PRIORITYET: Ngritja dhe funksionimi i qendrave rinore; një në qytetin e Durrësit dhe një në Katund të Ri, gjithashtu ngritja dhe funksionimi i një biblioteke kryesore për Durrës qendër. Nuk është adresuar.

04 PRIORITYET: Zhvillimi i programeve edukative për ngritjen e bizneseve të të rinjve dhe grave dhe informimi i vazhdueshëm i publikut mbi programet që zhvillohen zbaton Bashkia për ngritjen e punësimit me fokus të rinjve, gratë kryefamiljare pjesëtarë madhësor të familjeve me ndihmë ekonomike. Adresuar pjesërisht.

05 PRIORITYET: Ngritja dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbra në qytet dhe nësitë administrative; ndërtimi në kanale kulluese dhe vaditëse në njësitë administrative Manëz, Katund i Ri, Rrëshbull dhe Sukth, Vjimi i investimeve që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe shpallistikën në Rr. A. Goga; Stacionin e Trenit - Ura e Dajllanit; Shkozët; si edhe në Manëz (Kameras, Kucok); Rrëshbull (ShënVlash); Katund i Ri dhe Sukth (rrugët dytësore bujqësore). Adresuar pjesërisht.

06 PRIORITYET: Shtimi i koshave për mbledhjen e mbetjeve urbane dhe tërheqja e tyre nga makina e mbledhjes së mbeturinave të pakten një herë në dy ditë në të gjitha lagjet e bashkisë Durrës. Adresuar pjesërisht.

07 PRIORITYET: Përmirësimi në infrastrukturën e shkollave (sisteme ngrohjeje, laboratorë të informatikës) si edhe plotësimi i strukturës me personel për pastrimin dhe ruajtjen e shkollave në njësitë administrative të Bashkisë Durrës. Adresuar pjesërisht.

08 PRIORITYET: Rikonstruksioni i kopshteve dhe çerdheve në lagjet periferike të qytetit Durrës, në Sukth, Katund i Ri dhe Rrëshbull. Adresuar pjesërisht.

09 PRIORITYET: Përmirësimi i cilësisë së transportit publik (përcaktimi dhe publikimi i orarëve të transportit publik; korrektësi në orarët e mbledhjes në stacion, përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare, rritja e shpejtësisë së autobusëve dhe e kolektivitetit të këtyrë shërbimeve edhe pas orës 17.00) në njësitë administrative të bashkisë Durrës. Nuk është adresuar.

10 PRIORITYET: Zgjidhja e çështjes së transportit të fëmijëve për në shkollat për shkak të distancës së largët nga vendbanimi në njësitë administrative Rrëshbull dhe Sukth. Adresuar pjesërisht.

11 PRIORITYET: Zgjidhja me prioritet e furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet për lagjet e qytetit të Durrësit dhe njësive të tjera administrative. Adresuar plotësisht.

12 PRIORITYET: Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë dhe ngritja e shërbimeve të reja sipas nevojave të vlerësuar në lagjet e qytetit Durrës në njësitë administrative Manëz, Sukth, Katund i Ri dhe Rrëshbull. Adresuar plotësisht.

13 PRIORITYET: Zgjerimi i programeve ndërrrejtëse dhe informuese për komunitetin në lidhje me: dhunen në familje, shërbimet mbrojtëse, fuqizuese dhe rritëse për viktimat e... Adresuar pjesërisht.

DURRËS

Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile:

Nga 13 prioritetet të Kontratës Sociale pranë kësaj bashkie 3 prej tyre janë adresuar plotësisht, 8 pjesërisht dhe 2 prioritetet nuk janë adresuar nga bashkia. Pikërisht për ato prioritetet të cilat nuk janë prekur akoma CSDC vijon lobimin për përfshirjen e tyre në axhendatat e pushtetit vendor. Duke klikuar [këtu](#), do të dëgjoni më shumë mbi arritjet e POP në Durrës.

FIER

Epoka e Re: Nga pesë prioritetet e Kontratës Sociale pranë bashkisë Fier, 3 prej tyre kanë patur një përmirësim të dukshëm duke plotësuar pikat më kryesore të çështjeve të ngritura. Ndërkohë që Epoka e Re vijon aktivitetet lobuese dhe aktivitetet pranë komunitetit për përmbushjen edhe të 2 prioritetëve që bashkia nuk i kishte në axhendën e saj gjatë vitit të parë të monitorimit. Duke klikuar [këtu](#) mund të ndiqni prezantimin e POP në Fier pranë tv lokale.



KONTRATA SOCIALE FIER PËRMBUSHJA E PRIORITYEVE Viti i parë i monitorimit

01 PRIORITYET: Transparenca në menaxhinin e Njësisë së qeverisjes vendore, duke nisur nga njoftimet publike. Ato duhet të jenë më të shpeshta, të shtrira në kohë dhe publike; Akses të komunitetit dhe të të rinjve në dëgjuesat publike e në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Adresuar pjesërisht.

02 PRIORITYET: Ndërtimi i sa më shumë terreneve sportive në qytet dhe Njësi Administrative, si dhe vënja në funksion e shkollave si qendra komunitare, kryesisht në zonat rurale. Adresuar pjesërisht.

03 PRIORITYET: Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për Gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë. Nuk është adresuar.

04 PRIORITYET: Buxhet specifik për të rinjtë dhe ngritja e një strukture (Drejtoria) të vecantë në Bashki që të koordinojë marrëdhënien dhe ndërveprimin me të rinjtë. Adresuar pjesërisht.

05 PRIORITYET: Kthimi në identitetin Qëndrës Kulturorë të Fëmijëve, duke rikthyer gjithashtu edhe grupet e kurset e fëmijëve, të cilët sot janë të papërfqësuar. Nuk është adresuar.

Lexoni Raportin e detajuar në: <https://popnetwork.al/raporti-nje-vjecar-kontrata-sociale-bashkia-fier/>



KUKËS

Qendra për Progres Rinor:

Janë zhvilluar një sërë takimesh me komunitetin dhe me përfaqësues të bashkisë Kukës. Është Drejtorja e Rinisë pranë kësaj bashkie e cila është lobuesi dhe bashkëpunëtori më i ngushtë i QPR për advokimin e prioriteteve të Kontratës Sociale pranë kësaj bashkie. Gjatë vitit të parë të monitorimit vetëm 50% e prioriteteve u adresuan në mënyrë të pjesshme nga kjo bashki, dhe lobimi vijon për plotësimin e tyre të plotë si edhe për të sjellë në vëmendje të bashkisë ato prioritete të cilat nuk janë adresuar akoma. Për të mësuar më shumë mbi arritjet e POP në Kukës klikoni [këtu](#).



TIRANË

Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim"

Bashkia më e madhe në vend Tirana ka adresuar në mënyrë të pjesshme apo të plotë rreth 72% të prioriteteve. GADC gjatë muajve të parë të vitit ka organizuar disa takime në vend dhe online për lobimin e aktiviteteve të adresuara akoma nga kjo bashki. Për të mësuar më shumë rreth përbushjes së prioriteteve të Kontratës Sociale në Tiranë por edhe për arritjet e POP klikoni [këtu](#) për të ndjekur kronikën në media.





VLORË

Qendra Rinore e Vlorës: Në kuadër të lobimit dhe advokimit për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale pranë kësaj bashkie, janë organizuar disa takime të njëpasnjëshme me anëtarë të komunitetit, përfaqësues të bashkisë, departamenteve përkatëse si edhe prezantime lokale televizive dhe radiofonike. Janë rreth 7 prioritete të cilat janë adresuar pjesërisht, 2 prej tyre janë adresuar dhe plotësuar sipas çështjeve dhe puna lobuese vazhdon për përmbushjen e dy prioriteteve që kjo bashki nuk i ka adresuar akoma. Klikoni [këtu](#) për të mësuar më shumë rreth arritjeve të POP në Vlorë.

SHKODËR

Bashkia e Shkodrës ka adresuar në mënyrë të plotë 4 nga 7 prioritetet e Kontratës Sociale pranë kësaj bashkie. Ndërkohë që 2 të tjera janë të adresuara në mënyrë të pjesshme, IRSH vijon takimet lobuese dhe advokuese për adresimin e prioritetit që rezulton i papërmbushur gjatë vitit të parë të monitorimit. Për të mësuar më shumë mbi arritjet e POP në Shkodër klikoni [këtu](#).



TAKIMI I RRJETIT POP

Në Pogradec në mars 2021 u realizua takimi i rradhës i Rrjetit POP me pjesëmarrjen e të gjitha organizatave të rrjetit si edhe me përfaqësues të Olof Palme International Center. Në këtë takim u miratua njëzëri zgjerimi i rrjetit si edhe shtimi i tre bashkive të reja në POP. Tashmë POP shtrihet në Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Kamëz, Shkodër, Kukës, Pukë, Pogradec, Elbasan, Korçë dhe Vau i Dejës. Rrjeti POP ndër të tjera vendosi edhe monitorimin e fushatës parazgjedhore të zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit si edhe takime lobuese dhe advokuese me kandidatët për deputetë në kuadër të Kontratës Sociale 2019 dhe të Paktit Sociale të vitit 2017.



Monitorimi i Zgjedhjeve Parlamentare 25 prill 2021

Në kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare të 25 prill 2021, anëtarët e Rrjetit POP monitoruan në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e fushatës, duke sjellë më afër qytetarëve edhe informacionet e rëndësishme sa i përket procesit të votimit apo/dhe numërimit të votave. Platforma POP u vendos në dispozicion të informacioneve të ecurisë së fushatës në të gjitha format e saj qoftë në website ashtu edhe në Mediat Sociale.

Gjatë fushatës, i gjithë Rrjeti POP organizoi takime me kandidatë të ndryshëm nga të gjitha partitë politike në garë, duke ju prezantuar Paktin Social të vitit 2017 dhe Kontratën Sociale të vitit 2019. Gjatë këtyre takimeve u kërkua angazhimi i kandidatëve që nëse arrijnë të sigurojnë një vend në parlament të advokojnë për përmbushjen e atyre prioriteteve të qytetarëve të cilat kanë të nevojshëm edhe angazhimin e qeverisë për përmbushjen e tyre. Klikoni [këtu](#) për më shumë detaje nga POP për këtë proces.

Forumet Publike në kuadër të Zgjedhjeve parlamentare 2021

Rrjeti POP organizoi 7 Forume Publike në 7 qarqe të vendit për të sjellë kandidatët për deputetë pranë qytetarëve, për prezantimin e programeve të tyre politike sipas partive si edhe për të diskutuar nga afër planet apo projektet që secila parti ofron gjatë mandatit 4 vjeçar. Forumet publike u organizuan në qarqet: Tiranë; Durrës; Fier; Shkodër; Korçë; Vlorë dhe Kukës.

Diskutimet u bazuan në tre shtylla kryesore:


- Programet politike respektive;
- Pakti Social 2017 – Puna e Denjë dhe Paga minimale; Financimi për Arsimin si dhe Ligji për Referendumet.

Kontratata Sociale 2019 – Prioritetet e papërbushura nga pushteti vendor dhe nevoja e tyre për vëmendjen e qeverisë.



DURRËS

Në Forumin Publik në Durrës pranuan ftesën kandidatët nga: Lëvizja Socialiste për Integrim, Bindja Demokratike, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Partia Demokratike dhe Nisma Thurje. Në forum morën pjesë qytetarë të Durrësit dhe anëtarë të organizatave të shoqërisë civile, të cilët orientuan diskutimin rreth çështjeve rinore, çështjeve të lidhura me infrastrukturën, arsimin dhe ato sociale për grupet e marginalizuara. Duke klikuar [këtu](#) mund të ndiqni diskutimet e këtij forumi.



KUKËS



Në takim hibrid në Kukës vetëm Partia Demokratike pranoi ftesën e POP. Takimi u transmetua drejtpërdrejt në Radio Kukës. Në forum moren pjesë gazetarë dhe aktivistë të organizatës, të cilët orientuan diskutimin rreth çështjeve rinore, kryesisht të lidhura me prioritetet e Kontratës Sociale dhe problematika të tjera rinore, sikurse është fenomeni i emigracionit dhe papunësia për Qarkun e Kukësit. Duke klikuar [këtu](#) mund të ndiqni diskutimet e këtij forumi.

VLORË

Ftesa për të marrë pjesë në Forumin e Vlorës u pranua nga Partia Socialiste, Partia Demokratike, Lëvizja Socialiste për Integrim, Lëvizja për Ndryshim dhe nga Nisma Thurje. Në forum u diskutua mbi platformat elektorale të secilit kandidat të orientuara drejt pikave të Paktit Social të vitit 2017 dhe Kontratës Sociale 2019, si prioritetet qendrore dhe lokale. Diskutimi u fokusua në tre shtylla kryesore të prioritetëve të qytetarëve të Vlorës: Arsimi dhe të rinjtë; Shëndetësia dhe Mjedisi dhe Zhvillimi i Turizmit. Klikoni [këtu](#) për të ndjekur forumin e plotë.



SHKODËR



Ftesa për të marrë pjesë në këtë forum u pranua nga Partia Socialiste, Partia Demokratike, Nisma Thurje dhe Lëvizja Socialiste për Integrim. Në forum u diskutua për platformat elektorale të secilit kandidat të orientuara drejt pikave të Paktit Social të vitit 2017 dhe Kontratës Sociale të vitit 2019. Diskutimi u fokusua në katër shtylla kryesore të prioritetëve të qytetarëve të Shkodrës: Shëndetësia, Zhvillimi Ekonomik/Punësimi i të Rinjve, Infrastruktura Publike/Infrastruktura Arsimore dhe Publike, Pjesëmarrja Qytetare dhe Transparenca/Pjesëmarrja e të rinjve në vendimarrje. Klikoni [këtu](#) për të ndjekur forumin e Shkodrës.

TIRANË

Ftesa për të marrë pjesë në Forumin e Tiranës u pranua nga Partia Socialiste, Partia Demokratike, Lëvizja Socialiste për Integrim, Bindja Demokratike dhe nga Nisma Thurje. Në forum u diskutua mbi platformat elektorale të secilit kandidat si edhe të orientuara drejt pikave të Paktit Social të vitit 2017 dhe Kontratës Sociale të vitit 2019, si prioritet qendror dhe lokal. Diskutimi u fokusua sipas prioritetëve të qytetarëve të Tiranës: Paga e Denjë; Buxhetimi për Arsimin, Referendumet dhe mungesa e një ligji të mirëfilltë, Konsultimi Publik dhe Transparenca; Shëndetësia, Infrastruktura.



Klikoni [këtu](#) për të ndjekur forumin e plotë.

FIER

Ftesa për të marrë pjesë në forumin e Fierit u pranua nga Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Nisma #Thurje.

Në forum u diskutua mbi platformat elektorale të secilit kandidat të orientuara drejt problematikave të komunitetit të Fierit dhe ofertave politike që partitë sjellin në këtë garë duke u fokusuar tek Shëndetësia; Zhvillimi Ekonomik; Infrastruktura Publike; Pjesmarrja Qytetare dhe Transparenca. Klikoni [këtu](#) për të ndjekur të plotë forumin e Fierit i cili u transmetua në lidhje direkte edhe në tv lokal.



KORÇË

Ftesa për të marrë pjesë në Forumin e Korçës u pranua nga Partia Demokratike, Lëvizja Socialiste për Integrim, Bindja Demokratike dhe nga Nisma Thurje. Në forum u diskutua mbi platformat elektorale të secilit kandidat të orientuara drejt problematikave të komunitetit të Korçës dhe ofertave politike që partitë sjellin në këto zgjedhje duke u fokusuar tek Shëndetësia; Zhvillimi Ekonomik; Infrastruktura Publike; Pjesmarrja Qytetare dhe Transparenca. Klikoni [këtu](#) për të ndjekur forumin e Korçës.



ÇFARË PROPOZUAN PARTITË POLITIKE PËR MANDATIN 2021-2025

I. Rritja e pagës minimale dhe puna e denjë

"Projekte të mëdha strategjike do të krijojnë vendet e duhura të punës që qytetarët të punësohen. Rritja e pagës minimale nga 30,000 në 40,000 lekë. Rritja e punësimit në sektorët strategjikë, duke mos përjashtuar edhe çështjen e taksës 0 për biznesin e vogël që ka krijuar një efekt pozitiv edhe gjatë kohës së pandemisë."



Znj. Romina Kuko - PS



Z. Edmond Haxhinasto - LSI

"LSI ka vendosur uljen e koston së jetesës si një objektiv kryesor. Rimbursimi 5% i kuponit tatimor. Punësim i mirëpaguar veçanërisht për rininë. Sa i përket pagës minimale kërkohet një llogaritje serioze, jo vetëm për çështjen e pagës por për të gjitha aspektet e tjera sociale."

"Nisma THURJE këto çështje i ka grumbulluar në projektligjin e sigurisë së jetës ku përfshihet edhe ai i minimumit jetik, ku një qytetar shqiptar nuk mund të marrë më pak se 150\$ në muaj sipas Instat. Përsa i përket ndihmës ekonomike, bashki të ndryshme nëse kanë në dispozicion mundësi siç mund të jenë kioskat për biznes, do të ishin ndihmë për këtë kategori që të mos varen vetëm nga ndihma ekonomike por ti marrin për ti menaxhuar ato."



Znj. Borana Tartari - Thurje



Znj. Orjola Pampuri - PD

"Propozimi i taksës së sheshtë prej 9% është një nga mundësitë që do të gjenerojë më shumë vende pune dhe të ardhura në xhepat e shqiptarëve. Dyfishimi i ndihmës ekonomike duhet llogaritur dhe duke u bazuar në koston e jetesës. Paga minimale prej 36,000 lekë në muaj, nis me këtë shifër. Lehtësimi dhe mundësimi që çdokush të marrë mbështetje në punësim dhe në ndihmë ekonomike është një nga pikat e forta të Partisë Demokratike."

I. Rritja e pagës minimale dhe puna e denjë

"Bindja Demokratike është përpjekur të formulojë disa teza, por sa më larg populizmave të vështira për tu arritur. Evidentojmë një problem shumë të madh në polarizimin ekonomik, ne kemi ideuar reforma të thella shtetërore që nxisin lirinë ekonomike për të mos pasur kaq shumë të varfër sa ka Shqipëria sot. Numri i shqiptarëve që jetojnë nën minimumin jetik është mjaft i lartë. Rritja e pagës minimale duhet të bëhet me reforma të thella që nxisin lirinë ekonomike dhe zhvillimin e vendit.."



Z. Fabian Topollaj - DB

II. Mbështetja financiare në sektorin e Arsimit

Në Paktin Social 2017 u mor angazhimi për një rritje të financimeve për arsimin deri në 6% të Prodhimit të Përgjithshëm Kombëtar. Në katër vitet e fundit, mbështetja buxhetore nuk i ka kaluar 3.5% të GDP-së. A shihni mundësi që për këtë sektor të jepet më shumë mbështetje financiare dhe si mund të bëhet kjo?

Lëvizja Socialiste për Integrim

- Propozuar dyfishimin e GDP-së që shkon për arsimin;
- Propozuar dyfishim të pagave për mësuesit në 4 vitet e ardhshme;
- Propozuar Taksën e së ardhmes për 200 bizneset më të mëdha në vend, të ardhura këto që do të shkojnë për të përgatitur studentët për tregun e punës;
- Rikonceptim të mënyrës se si funksionon sistemi arsimor;
- Për shkollat e mesme profesionale, masivizim të tyre nëpërmjet programin "Mëso dhe Fito"

Partia Demokratike

- Stazh të paguar për 5000 studentë çdo vit - duke ofruar që ky stazh të merret si eksperiencë pune;
- Mundësi për arsimin e lartë falas për të gjithë të rinjtë që kanë 65,000 lekë apo më pak të ardhura familjare në muaj;
- Libra falas për sistemin 9-vjeçar dhe të mesëm;
- Një vakt ushqimor në shkollë në sistemin 9-vjeçar;
- Financim për kërkimin shkencor.

Lëvizja Socialiste për Integrim

"Nëse ne arrijmë që buxhetit për arsimin ti japim një rritje vjetore 0.5% të prodhimit të brendshëm bruto është një arritje mjaft e lartë. Në fund të një mandati qeverisës, buxheti të arrijë në nivelin e buxheteve të shteteve fqinje do të ishte një arritje mjaft e madhe dhe e rëndësishme. Duhet të kthehet në hullitë kushtetuese edhe ligji për arsimin e lartë dhe arsimin parauniversitar. Të shtrihet mbështetja edhe për studimet master dhe duhet të bëhet një plan kundër analfabetizmit dhe të ketë shkolla në çdo vend ku ka nxënës. Shkollat që janë mbyllur në zonat rurale duhet të rihapen sa më parë."

II. Mbështetja financiare në sektorin e Arsimit

Në Paktin Social 2017 u mor angazhimi për një rritje të financimeve për arsimin deri në 6% të Prodhimit të Përgjithshëm Kombëtar. Në katër vitet e fundit, mbështetja buxhetore nuk i ka kaluar 3.5% të GDP-së. A shihni mundësi që për këtë sektor të jepet më shumë mbështetje financiare dhe si mund të bëhet kjo?


Partia Socialiste

- Një nga zotimet që do të realizohet është rritja me 40% e pagave të mësuesve;
- Pjesa e GDP-së duhet specifikuar sesi shpenzohen në projektet e duhura dhe drejtimet e duhura; Fokusi – Inovaconi dhe arsimimi në fushat e reja nga mosha 12 deri 18 vjeç
- 40 shkollat e reja që po ndërtohen kanë të parashikuar edhe laboratorët për kërkimin shkencor;
- Skema atraktive që universitetet e huaja të kenë filiale edhe në Shqipëri;
- Internship për studentët gjatë kohës që janë duke zhvilluar studimet e tyre;
- Shkollat si qendra komunitare dhe Riangazhimi i mësuesve që kanë dalë në pension.

Nisma Thurje

- Të gjitha familjet me të ardhura nën 500 Euro në muaj të kenë mundësinë që të regjistrojnë fëmijët në universitet falas;
- Rishikimi i vlerës së diplomave të studentëve, të cilët edhe pse të diplomuar shumë prej tyre edhe me master, vijojnë të mos gjejnë hapësira dhe punësohen në call-center apo emigrojnë jashtë vendit duke bërë punë të rëndomta edhe pse me diploma universitare në Shqipëri.
- Kërkimet shkencore që kanë munguar – duhet ti bashkëngjiten projektligjeve qeveritare.
- Çdo nismë qeveritare të ketë një raport shkencor që të ketë dalë nga universitetet tona, duke i rritur kështu vlerën pa patur nevojë që këto raporte apo studime të merren nga jashtë.

III. Ligji për Referendumet



Lëvizja Socialiste për Integrim

Partia Demokratike

Bindja Demokratike

Partia Socialiste

Nisma Thurje

RRJETI POP

Përballja e Ofertave Politike (POP) është një rrjet i organizatave të shoqërisë civile i cili synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve gjatë zgjedhjeve vendore dhe qendrore, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Përmes aktiviteteve dhe nismave, rrjeti POP synon të forcojë zërin e qytetarëve Shqiptarë në çështje të demokracisë, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien para zgjedhjeve, gjatë dhe periudhës pas tyre.

Përballja e Ofertave Politike - POP, mbështetet nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: "Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social" si dhe nga "The National Endowment for Democracy".

Anëtarët e Rrjetit POP:

- Qendra Aleanca Gjinore per Zhvillim, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë;
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës;
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec.

Na ndiqni duke klikuar në:

